



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. 6213 prot.

Ballsh ,më 20.12 .2023

PROJEKT - VENDIM
Nr. 47 Datë 20 / 12 / 2023

PËR
MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË LIKUIDIMIT DHE ÇREGJISTRIMIN E
SHOQËRISË UK MALLAKASTËR

- KËSHILLIT TË BASHKISË

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e takasave vendore”, Udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKB nr. 46, datë 30.08.2022 “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjetllës Kanalizimeve” Marrëveshjes së Bashkëpunimit për transferim aktiviteti nr. 1361 Rep., Nr. 619 Kol date 07.10.2022 ndermjet Sh.a Ujesjetlles Kanalizime Mallakaster dhe Shoqerise Rajonale Ujesjetlles Kanalizime Fieri, VKB nr. 12, datë 24.02.2020 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak, materialit të paraqitur nga ana e Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër sh.a. në lidhje me përfundimin e likuidimit dhe çregjistrimin e shoqërisë UK Mallakastër me anë të Vendimit Nr.09 datë 20.12.2023 “Për miratimin e përfundimit të likuidimit dhe çregjistrimin e Shoqërisë”,

PROPOZOJ:

1. Miratimin e përfundimt të likuidimit dhe çregjistrimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër sh.a. nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
2. Ky projekt vendim shoqërohet me dokumentacionin bashkëlidhur të paraqitur nga Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër sh.a..

KRYETAR

Qerim Ismajaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**SHOQERIA UJËSJELLËS KANALIZIME MALLAKASTER SH.A.
LIKUIDUESI**

Nr. 40 Prot.

Mallakaster, më 12/12/2023

Lënda: Njoftim për shpërndarje të aktiveve nga likuidimi i shoqërisë.

Drejtuar: Bashkia Mallakaster

Të nderuar,

Shoqëria shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Mallakaster Sh.A. ka mbyllur procesin e likuidimit dhe në përputhje me ligjin po veprojmë me shpërndarjen e aktiveve në favor të aksionarëve.

Nëpërmjet kësaj shkrese Ju njoftojmë se në cilësinë e aksionarit të shoqërisë, ku Ju zotëroni 100% të aksioneve, Ju përfitoni nga shpërndarja e aktiveve një vlerë prej 239,148,062 lekë. Këto aktive janë të drejta ndaj Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier sha me NIPT M23315402G.

Për sa më sipër, duhet të bëni rregullimet në librat Tuaj kontabël. Për këtë është njoftuar nga ana jonë edhe debitori Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier sha.

LIKUIDUESI

Eqerem Beqiraj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**SHOQERIA UJËSJELLËS KANALIZIME MALLAKASTER SH.A.
ASAMBLEJA E AKSIONAREVE**

Nr. 6208 prot.

Mallakaster, më 20.12.2023

VENDIM

Nr. 099 datë 20.12.2023

PËR

**MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË LIKUIDIMIT DHE ÇREGJISTRIMIN E
SHOQËRISË**

Shoqëria shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Mallakaster Sh.A. në likuidim, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT J63423411D, mbajti mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve. Mbledhja u thirr nga likuiduesi i shoqërisë zoti Eqerem Beqiraj, për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

1. Përfundimi i procedurave të likuidimit dhe çregjistrimi i Shoqërisë shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Mallakaster Sh.A.

Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve vëren:

Shoqëria shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Mallakaster Sh.A. është shpallur në likuidim në datën 13.04.2023. Vendimi si dhe njoftimet e kreditorëve janë publikuar rregullisht në QKB. Shoqëria nuk ka pasur aktive dhe detyrime, pasi në tërësi aktiviteti ekonomik dhe aktivitetet se bashku me detyrimet janë transferuar në favor të Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier sha në datë 31.12.2022.

Likuiduesi ka hartuar bilancin e gjendjes në çastin e hapjes së likuidimit në datë 13.04.2023. Gjithashtu likuiduesi ka hartuar një bilanc gjendje në datën 12.12.2023. Pas kësaj likuiduesi ka vepruar me shpërndarjen e aktiveve dhe ka hartuar një raport përfundimtar të likuidimit në datën 12.12.2023..

Pasi shqyrtoi raportin përfundimtar të likuidimit dhe diskutoi mbi çështjen më sipër të rendit të ditës, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve unanimsisht,

VENDOSI:

- (1) Miratimin e bilancit të gjendjes në çastin e hapjes së likuidimit në datë 13.04.2023 si dhe pasqyrave financiare për periudhën 1 Janar 2023 deri 13 Prill 2023 si dhe rezultatit financiar prej 0 (zero) lekë për këtë periudhë.
- (2) Miratimin e bilancit të gjendjes në çastin e mbylljes së likuidimit në datë 12.12.2023 si dhe pasqyrave financiare për periudhën 13 Prill 2023 deri 12 Dhjetor 2023, si dhe rezultatit financiar prej 0 (zero) lekë për këtë periudhë.
- (3) Miratimin e raportit përfundimtar të likuidimit të datës 12.12.2023, hartuar nga likuiduesi i shoqërisë Z. Eqerem Beqiraj.
- (4) Miratimin e shpërndarjes së aktiveve, të drejtat ndaj Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sha në favor të aksionarëve si vijon:

Aksionari	Përqindja e pjesëmarrjes	Vlera në Lekë e të drejtave në Shoqërinë Rajonale
Bashkia Mallakaster	100%	239,148,062
TOTAL	100.00%	239,148,062

- (5) Mbylljen e procesit të likuidimit, prishjen e shoqërisë dhe çregjistrimin e Shoqërisë shoqëria Ujësjellës Kanalizime Mallakaster Sh.A. nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
- (6) Ngarkohet likuidatori me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ASAMBLEJA E AKSIONAREVE TË SHOQERIA UJËSJELLËS KANALIZIME
MALLAKASTER SH.A.**

Qerim

